




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 635/1
prot.

Shkodër, më 13.10.2025



Lënda: Mbi vendimin Nr. 35, datë 25.09.2025 të Këshillit Bashkiak Fushë Arrëz.

KËSHILLI BASHKIAK FUSHË ARRËZ

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", të ndryshuar, neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 21, datë 05.02.2025 "Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 39, datë 20.02.2025 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 41, neni 55 pika 3, neni 64, shkronja "c", ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore", i ndryshuar, neni 38, të Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 28.02.2025 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028", shqyrtoi vendimin Nr. 35, datë 25.09.2025 të Këshillit Bashkiak Fushë Arrëz "Mbi miratimin e projektit të dytë të programit buxhetor afatmesëm (FPT) 2026-2028, sipas dokumentacionit të mbledhjes bashkëlidhur".

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon të procedoni, duke i konsideruar prioritet për zbatim mendimet e dërguara nga MF me shkresën nr.9739 prot, datë 18.06.2025¹.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI



¹ Të jenë pjesë e dokumentacionit edhe seancat dëgjimore me komunitetin dhe grupet e interesit